



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1210/1 prot.

Tiranë më 13.102020

Lënda: Mendim mbi një projektligj

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 118441/8 Prot., datë 6.10.2020, projektligji "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", në tërësi vlerësohet i hartuar konform Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar (në vijim "ligji për mbrojtjen e të dhënave personale").

Megjithatë, nga pikëpamja e teknikës legislative dhe me qëllim unifikimin e terminologjisë me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i qëndron propozimit të dhënë më parë me shkresën nr. 771/1 Prot., datë 09.07.2020, nëpërmjet të cilës sugjerojmë që pika 6, e nenit 31 të projektligjit, të ndryshohet si vijon: "Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale, do të kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale".

Referuar relacionit të projektligjit, vërejmë se ky propozim është pranuar nga ana juaj, por konstatohet që nuk është reflektuar në projektligj. Ky ndryshim duhet të realizohet sepse koncepti "legjislacion" është më i gjerë se ai "ligj", pasi përfshin edhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara si dhe aktet nënligjore të Komisionerit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

